


	<b>Procedura për shqyrtimin e ankesave nga palët e treta lidhur me qasjen në rrjet dhe shfrytëzimin e rrjetit të transmetimit</b>	PR-ÇRT-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 1 nga 7</i>
<i>Departamenti: Çështjet Rregullative dhe Tarifa</i>		<i>Sektori për Çështje Rregullative</i>


OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI DHE TREGU KOSTT sh.a  
 TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR KOSTT J.S.C  
 OPERATOR SISTEMA PRENOSA I TRZIŠTA KOSTT d.d

Nr. 820/010 Dt. 03 02 2018  
 PRISHTINË-A

## Procedura për shqyrtimin e ankesave nga palët e treta lidhur me qasjen në rrjet dhe shfrytëzimin e rrjetit të transmetimit

	Përgatiti	Kontrolloi SMC	Aprovoi
Emri Mbiemri	Labinot Gashi	Shukrije Fetahaj Fëllënëza Xhelili Fiqi	Ilir M Shala
Nënshkrimi			
Data	28 Qershor 2018	Qershor 2018	Korrik 2018



	<b>Procedura për shqyrtimin e ankesave nga palët e treta lidhur me qasjen në rrjet dhe shfrytëzimin e rrjetit të transmetimit</b>	<b>PR-ÇRT-004</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 2 nga 7</i>
<i>Departamenti: Çështjet Rregullative dhe Tarifa</i>		<i>Sektori për Çështje Rregullative</i>

## 1. Hyrje

Kjo Procedurë është krijuar në bazë të dispozitës ligjore Neni 16, pika 1.33 të Ligjit për Energjinë Elektrike, në bazë të së cilit KOSTT do të krijoj Komisionin për Ankesa, në lidhje me qasjen në rrjet dhe shfrytëzimin e rrjetit të transmetimit në përputhje me dispozitat që rregullojnë mbrojtjen e konsumatorëve, si dhe krijimin e një mekanizimi të pavarur për zgjidhjen jashtë gjyqësore të mosmarrëveshjeve.

## 2. Qëllimi


Ky dokument përcakton kushtet dhe procedurat për parashtrimin, shqyrtimin dhe mundësisht zgjidhjen jashtë gjyqësore të ankesave/mosmarrëveshjeve të palëve të treta ndaj KOSTT për çështjet që ndërlidhen me qasjen në rrjet dhe shfrytëzimin e rrjetit të transmetimit (përveç çështjeve që ndërlidhen me Tregun e Energjisë Elektrike). Kjo procedurë do të publikohet në faqen elektronike të KOSTT dhe do të jetë në dispozicion për të gjitha palët përkatëse.

Shqyrtimi i ankesave të parashtruara nga palët e treta do të bëhet nga Komisioni i brendshëm i KOSTT i formuar me një vendim të posaçëm nga Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT.

## 3. Roli i Komisionit

Komisioni për shqyrtimin e ankesave në lidhje me qasjen në rrjet dhe shfrytëzimin e rrjetit të transmetimit ka për detyrë që:

- a) Te siguroje trajtimin e barabarte dhe jo-diskriminues ndaj te gjitha palëve të treta që parashtrojnë një ankesë.
- b) Të analizon në mënyrë të drejtë, në përputhje me këtë procedurë dhe të identifikon dhe parandalon thellimin e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve;
- c) Të tentoj që të zgjidhë kontestet që paraqiten midis palëve të treta dhe KOSTT
- d) Të promovoj qasje transparente dhe të hapur ndaj informacioneve që kanë të bëjnë me zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve
- e) Të sigurojë që procedura të jetë e zbatueshme në mënyrën më të mirë të mundshme për ankesat e palëve të treta dhe detyrimet e KOSTT për të adresuar ankesat e tyre
- f) Mundësisht të ofrojë zgjidhjen alternative të kontesteve
- g) Zgjidhjet e ankesave të trajtohen në mënyrë të shpejtë, në përputhje me afatet e përcaktuara në këtë Procedurë

	<b>Procedura për shqyrtimin e ankesave nga palët e treta lidhur me qasjen në rrjet dhe shfrytëzimin e rrjetit të transmetimit</b>	<b>PR-ÇRT-004</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 3 nga 7</i>
<i>Departamenti: Çështjet Rregullative dhe Tarifa</i>		<i>Sektori për Çështje Rregullative</i>

#### 4. Trajtimi dhe menaxhimi i Ankesave

Procesi i trajtimit dhe menaxhimit të ankesave do të monitorohet nga menaxhmenti i lartë i KOSTT. Kjo procedurë do të miratohet nga Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT.

Procesi i trajtimit dhe menaxhimit të ankesave do të zbatohet sipas kësaj procedure e cila do ti vihet në dispozicion të gjithë stafit përkatës të KOSTT dhe palëve të treta.

Procesi i menaxhimit të ankesave do të bëhet nga Kryetari i Komisionit, i cili do të mbikëqyr komisionin e trajtimit të ankesave, i cili do të raportojë drejtpërdrejtë tek menaxhmenti i lartë i KOSTT respektivisht te Drejtori i Departamentit me të cilën veprimtari është e ndërlidhur çështja e ankesës.

Komisioni për shqyrtimin e ankesave nga palët e treta do të raportoj tek Menaxhmenti i lartë i KOSTT në baza 3 mujore.


#### 5. Parashtrimi i ankesave

- Çdo individ, person fizik ose juridik mund të ketë të drejtë t'i drejtohet nëpërmjet një ankese, Komisionit të Ankesave në KOSTT lidhur me qasjen në rrjet dhe shfrytëzimin e rrjetit të transmetimit;
- Ankesa duhet të plotësohet me të dhënat e kërkuara sipas formatit të paraqitur në Shtojcën 1 të kësaj procedure;
- Formulari i ankesës mund të shkarkohet nga faqja zyrtare e internetit të KOSTT ose mund të tërhiqet pranë zyrave të Arkivës së KOSTT
- Ankesa paraqitet në formë të shkruar pranë Zyrës së Arkivës së KOSTT dhe duhet të përmbajë të dhëna të rëndësishme, fakte dhe rrethana mbi cenimin dhe shkëlqen e të drejtave dhe detyrimeve nga KOSTT të parapara me kornizën ligjore dhe rregullative;
- Në rast se ankesa nuk përmbush kriteret formale të përcaktuara në Shtojcën 1 të këtij dokumenti, Komisioni i Ankesave, brenda 5 ditëve kalendarike nga mbërritja e ankesës, kërkon plotësimin me të dhëna shtesë

#### 6. Qasja në informacion

Komisioni, gjatë shqyrtimit të ankesës, ka të drejtë:

- të kërkojë nga pala dorëzimin e dokumenteve shtesë;
- të kërkojë nga pala të sigurojnë shpjegime shtesë në lidhje me rrethanat e ankesës;
- të vizitojnë vendin apo objektin;

	<b>Procedura për shqyrtimin e ankesave nga palët e treta lidhur me qasjen në rrjet dhe shfrytëzimin e rrjetit të transmetimit</b>	<b>PR-ÇRT-004</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 4 nga 7</i>
<i>Departamenti: Çështjet Rregullative dhe Tarifa</i>		<i>Sektori për Çështje Rregullative</i>

- d) të kryejnë aktivitete të tjera të ngjashme për të siguruar informacion të nevojshëm të cilat kontribuojnë në zgjidhjen e ankesës;

## 7. Afatet kohore


- a) Ankesat duhet të fillojnë të trajtohen nga Komisioni më së largu 3 ditë kalendrike pas arkivimit të saj. Çdo ankesë duhet të vlerësohet dhe vendimi mbi ankesën duhet të merret dhe ti komunikohet parashtruesit të ankesës në afatin maksimal brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendrike nga pranimi i saj nga Komisioni i shqyrtimit të Ankesave. Për ankesat më komplekse afati mund të zgjatet siç përshkruhet në paragrafin b);
- b) Çdo shtyrje kohore përtej kufijve të përcaktuar në paragrafin a) do të miratohet nga Kryesuesi i Komisionit për trajtimin e ankesave dhe shënjohehet në mënyrë specifike në bazën e të dhënave të ankesave. Komisioni i shqyrtimit të Ankesave do të informojë parashtruesin e ankesës menjëherë në lidhje me shtyrjen, shkakun e saj dhe datën e pritshme kur hetimi dhe vlerësimi ka të ngjarë të përfundojë. Kohëzgjatja e përgjithshme e shtyrjes nuk duhet të kalojë tridhjetë (30) ditë kalendrike pas afatit të vendosur në paragrafin a), përveç rasteve të veçanta të cilat për shkak të ndërlikueshmërisë së tyre kërkojnë kohë shtesë e cila duhet të aprovohet nga Kryeshefi Ekzekutiv, për ato raste kur zgjatja e afatit lejohet me ligjet në fuqi;
- c) Periudha gjatë së cilës Komisioni i shqyrtimit të Ankesave pret ti ofrohet informacion shtesë nga parashtruesi i ankesës nuk numërohet në afatin kohor për zgjidhje të ankesës;
- d) Data kur Komisioni i shqyrtimit të Ankesave merr ankesën konsiderohet të jetë data e pranimit të ankesës për qëllim të afatit kohor të përcaktuar me këtë nen. Nëse ankesa është pranuar gjatë një dite jo pune, afati për këtë ankesë do të llogaritet nga dita e parë e ardhshme e punës

## 8. Zgjidhja e Ankesave

Parashtruesi i ankesës do të informohet me shkrim për zgjidhjen e ankesës, nëpërmes letrës zyrtare të lëshuar nga KOSTT dhe përmes telefonit nëse këtë e preferon ankuesi. Përgjigja do të jetë e arsyeshme, koncize dhe e shkruar në gjuhë të thjeshtë me përdorimin minimal të gjuhës juridike apo profesionale.

Përgjigja përfundimtare për parashtruesin e ankesës duhet të përfshijë:

- (a) numrin identifikues/referues të ankesës;
- (b) një përmbledhje të ankesës;

	<b>Procedura për shqyrtimin e ankesave nga palët e treta lidhur me qasjen në rrjet dhe shfrytëzimin e rrjetit të transmetimit</b>	<b>PR-ÇRT-004</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 5 nga 7</i>
<i>Departamenti: Çështjet Rregullative dhe Tarifa</i>		<i>Sektori për Çështje Rregullative</i>

- (c) përmbledhja e përgjigjes (refuzimi apo zgjidhja e propozuar);
- (d) shpjegimi se si është arritur deri te përfundimi;
- (e) informatat kontaktuese të komisionit/personit që trajton ankesën;
- (f) hapat tjerë që mund ti ndërmarrin në rast se nuk pajtohen me përgjigjen e Komisionit kundrejt ankesës

### Shtojca 1: Formati i parashtrimit të Ankesës

## FORMULARI PËR ANKESË

Drejtuar

Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave për Qasje dhe Shfrytëzim të Rrjetit të Transmetimit

<b>Emri / Mbiemri:</b>
<b>Adresa:</b>
<b>Qyteti :</b>
<b>Telefon:</b>
<b>E-mail:</b>

<b>Ankesa kundrejt:</b>
<b>Adresa:</b>
<b>Qyteti:</b>

Përshkruani çdo veprim të pretenduar si shkelje nga KOSTT dhe nëse dispononi dokumente bashkëlidhni ato.

---



---



---



---



---



---




---



---

Përshkruani çfarë kërkon nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Qasje dhe Shfrytëzim të

	<b>Procedura për shqyrtimin e ankesave nga palët e treta lidhur me qasjen në rrjet dhe shfrytëzimin e rrjetit të transmetimit</b>	PR-ÇRT-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 6 nga 7</i>
<i>Departamenti: Çështjet Rregullative dhe Tarifa</i>		<i>Sektori për Çështje Rregullative</i>

Rrjetit të Transmetimit.

---



---



---



---



---



---



---

(Data) \_\_\_\_\_

(Nënshkrimi dhe Vula e Kompanisë) \_\_\_\_\_

*Ne nuk mund të pranojmë ankesën nëse nuk është nënshkruar.*

## 9. Formular

### 9.1 Burimet


Ligji për Energjinë Elektrike

### 9.2 Dokumentet dhe Formularët

## 10. Anekset

### 10.1 Lista e Shpërndarjes

Nr.	Emri dhe mbiemri	Data	Nënshkrimi
1.	Fëllënëza Xhelili, Drejtoreshë e Departamentit për Çështje Rregullative dhe Tarifa		
2.	Sabri Musiqi, Drejtor i Departamentit të Operatorit të Sistemit		
3.	Alban Imeri, Drejtor i Departamentit për Zhvillimin e Rrjetit dhe Projektet		
4.	Gazmend Kabashi, Menaxher i Zyrës për Zhvillim dhe Planifikim Afatgjatë		
5.	Anëtarëve të Komisionit të KOSTT		

	<b>Procedura për shqyrtimin e ankesave nga palët e treta lidhur me qasjen në rrjet dhe shfrytëzimin e rrjetit të transmetimit</b>	PR-ÇRT-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 7 nga 7</i>
<i>Departamenti: Çështjet Rregullative dhe Tarifa</i>		<i>Sektori për Çështje Rregullative</i>

## 10.2 Shënime për versionet

Versioni	Data	Përshkrimi	Kohëruajtja
1.0	Qershor 2018	Versioni Inicial	5 Vite